

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Zyrtar/e për Hulumtime dhe Analiza Ekonomike
Grada:	P06
Kohëzgjatja e punësimit:	Me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
Divizioni:	Divizioni i Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është në kërkim të një kandidati të kualifikuar dhe të motivuar për pozitën Zyrtar/e për Hulumtime dhe Analiza Ekonomike. Pozita ofron mundësi për zhvillim profesional në një mjedis analitik dhe kërkimor, me përgjegjësi në mbështetjen e analizave makroekonomike, zhvillimin e projeksioneve dhe përgatitjen e raporteve ekonomike. Kandidati i suksesshëm do të kontribuojë në aktivitetet kërkimore dhe analitike të departamentit, duke mbështetur vendimmarrjen përmes analizave të bazuara në të dhëna.

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna ekonomike dhe financiare duke aplikuar metoda statistikore dhe ekonometrike, me qëllim identifikimin e trendeve dhe mbështetjen e proceseve analitike dhe raportuese të departamentit;
- Zhvillon, mirëmban dhe përmirëson modelet dhe kornizat e projeksioneve makroekonomike, duke siguruar konsistencë metodologjike dhe saktësi analitike;
- Identifikon, vlerëson, strukturon dhe integron burime të ndryshme të të dhënave (vendore dhe ndërkombëtare), duke siguruar cilësi, koherencë dhe krahasueshmëri për analiza dhe modelim;
- Harton raporte analitike, analiza periodike dhe materiale prezantuese që paraqesin në mënyrë të qartë gjetjet kryesore, implikimet ekonomike dhe rekomandimet përkatëse për vendimmarrje;
- Koordinon dhe bashkëpunon me njësi të brendshme dhe institucione të tjera relevante për sigurimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit;
- Përbush detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, matematikës, shkencave kompjuterike ose shkencën e të dhënave (data science); preferohet diploma Master;

- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar, ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).

Kërkesat e posaçme:

- Kërkohen aftësi të shquara analitike dhe në interpretimin dhe analizimin e të dhënave;
- Kërkohet të demonstrojë aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, si dhe prezantimit para mbikëqyrësit dhe palëve të tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip, për menaxhim të kohës dhe përmbushje cilësore të detyrave; aftësi për bashkëpunim me mbikëqyrësin, ekipin dhe palët e jashtme;
- Shkathhtësi të mira statistikore dhe ekonometrike, si dhe njohuri të programeve për përpunimin dhe analizën e të dhënave;
- Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe përmbushjen e afateve;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku dy (2) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet
- të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 maj 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.